

Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Joani, merr pjesë në Samitin e Aqabës dhe viziton vendet e shenjta në Jordani



Në kuadër të 10-vjetorit të Procesit të Aqabës, u zhvillua Samiti i organizuar nga Mbreti i Jordanisë, z. Abdullah II bin Al-Husein dhe Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, nga data 8 – 9 dhjetor 2025 në Aqaba të Jordanisë, me pjesëmarrjen e udhëheqësve të komuniteteve fetare të Ballkanit dhe Lindjes.

Nga vendi ynë morën pjesë Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Joani; Arqipeshkvi i Tiranës, Monsinjon Arjan Dodaj; Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu.

Në Samit morën pjesë primatë të Kishave Orthodhokse, Patriarku i Jerusalemit, Theofili III; Patriarku i Antiokisë Joani X; Patriarku i Serbisë, Porfiri, me të cilët Kryepiskopi Joan zhvilloi takime, si dhe përfaqësues të Kishës Orthodhokse të Rumanisë, Bullgarisë, Kryepiskopatës së Ohrit etj.

Ndërsa nga Kisha Romano-Katolike mori pjesë Patriarku Latin i Jerusalemit,

Kardinali Pierbattista Pizzaballa. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të komuniteteve myslimane të Ballkanit dhe Lindjes së Mesme.

Samiti ishte një mundësi historike për t'iu drejtuar komuniteteve me respekt dhe dashuri vëllazërore, ku u theksua që popujt e rajonit ndajnë më shumë se një mijëvjeçar historie të përbashkët, të pasur me trashëgimi fetare, arritje kulturore, shkencore dhe artistike, por njëkohësisht edhe me periudha vuajtjesh, konfliktesh dhe plagë që kanë lënë gjurmë në kujtesën kolektive.

Përfaqësuesit shpresojnë që në të ardhmen do të thellohet bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndërfetar, me synim shërbimin ndaj komuniteteve, popujve dhe pakicave kombëtare. Në deklaratën e Samitit u rikujtuan figurat e shenjta dhe heronjtë e popujve të Ballkanit, të cilët me jetën dhe shembullin e tyre dëshmuar vlerën e besimit të gjallë. Shembulli i tyre duhet të frymëzojë jo vetëm pajtimin historik, por edhe solidaritetin konkret të përditshëm dhe bashkëpunimin konstruktiv. “Ne falim dhe kërkojmë falje” – ishte mesazhi qendror i dialogut për bashkëjetesë.

Kryepiskopi Joan dhe Kryedhjakoni Johan vizituan lumin Jordan, vendin e pagëzimit të Krishtit nga shën Joan Pagëzori dhe kishat e ndërtuara në këtë rajon.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)